

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me Kryetaren e kolegjit Afijete Sada-Gllogjani, Xhavit Elezi dhe Ismet Këndusi, anëtar dhe Vjollca Gaxha sekretare juridike, në çështjen juridike të propozuesve B.B nga fshati M., Komuna Gj., përfaqësuar nga i autorizuari B.R.dhe propozueses J.B. e vajzërisë B. nga fshati ..., Komuna Gj.s, përfaqësuar nga A. R. avokat nga Gj., për zgjidhje të martesës shkurorëzim me marrëveshje, në shqyrtimin përgatitor jo publik, në prezencën e të autorizuarve të propozuesve të mbajtur me datë 18 janar 2018, murr këtë:

A K T G J Y K I M

I. ZGJIDHET shkurorëzohet martesë me marrëveshje në mes të propozuesve B.B. i lindur me dhe J. B.. e vajzërisë B., e lindur me e lidhur me m.... ...në Zyrën e Gjendjes Civile Gjakovë, numër rendor ..., numri i referencës së

II. Fëmijët e përbashkët të propozuesve, të miturit B.B.e lindur me datën B.B. e lindur me datën dhe B....B.. i lindur me në fshatin ..., Gj.. i besohen në ruajtje, mbajtje dhe edukim të atit B.B.

III. Kontaktet e të miturve me të ëmën J.B. propozuesit do të i rregullojnë me marrëveshje.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesit me propozim dhe gjatë shqyrtimit nëpërmjet të autorizuarit të tyre kanë parashtruar se propozuesit kanë lidhur martesë me datë pranë organit kompetentë në Gj.... Në bashki martesore kanë tre fëmijë të përbashkët: B.B.e lindur me, B.B. e lindur medhe B.B. i lindur me fëmijë të tjerë nuk presin që të kenë. Propozuesit nuk kanë raporte të mira në mes janë përpjekur të bëhet pajtimi në mes tyre, por për shkak të keqësimit të vazhdueshëm të raporteve bashkëshortore nuk është arritur, ashtu që propozuesi ka vendosur të zgjidhë martesën. Është arritur marrëveshje në mes propozuesve që fëmijët ti besohen në edukim, ruajtje dhe mbajtje babait B. B., si dhe marrëveshja për mënyrën e vendosjes së kontaktit me fëmijët.

Propozuesi nuk ka parashtruar kërkesë të pagesës financiare të ushqimisë për të miturit. U propozua që propozimi të aprovohet si i bazuar.

Shpenzime procedurale nuk kërkojë. Heq dorë nga e drejta në ankesës.

I autorizuari i propozueses me propozim dhe gjatë shqyrtimit nëpërmjet të autorizuarit të sajë ka mbetet pranë të dhënave si në propozim dhe marrëveshjes së arritur mbi besimin e fëmijëve, që fëmijët ti besohen në mbajtje të atit, se është e pajtimit që martesë të zgjidhet me marrëveshje pasi që janë plotësuar kushtet ligjore, duke theksuar se bashkëshortët nuk presin që të kenë fëmijë në të ardhmen.

Shpenzime procedurale nuk kërkoi. Heq dorë nga e drejta në ankesë.

Për të vendosur në këtë çështje juridike Gjykata bëri nxjerrjen e provave; si certifikatës së martesës numër rendor ..., numri i referencës të datës, ekstrakteve nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile ..., E, E ... të datës, Mendimit të Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë nr..... të

datës, në kuptim të nenit 8 të LPK dhe nenin 68 pika 2 të Ligjit për Familjen aprovoj propozimin për zgjidhje të martesës me marrëveshje.

Nga certifikata e martesës vërtetohet se ndërgjyqësit me datë kanë lidhur martesë pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë.

Gjatë bashkësisë martesore ju kanë lindur fëmijët e përbashkët; B.. B..e lindur me, B. B.e lindur me .. dhe B.B. i lindur me

Qendra për Punë Sociale-Organi i Kujdestarisë ka njoftuar Gjykatën se procedura e pajtimit në mes të bashkëshortëve B. ka qenë e pasuksesshme, pasi marrëdhëniet bashkëshortore në mes tyre janë acaruar dhe nuk kanë mundur të përmirësohen. Sa i përket besimit të fëmijëve janë të pajtimit të respektohet vullneti i palëve që fëmijët ti besohen në ruajtje, mbajtje dhe edukim babait të fëmijëve, ndërsa kontaktet personale të fëmijëve me nënën e tyre të bëhen me marrëveshje në mes të dy bashkëshortëve.

Pasi që propozuesit janë pajtuar që fëmijët të i besohen në ruajtje, mbajtje dhe edukim të atit janë marr vesh lidhur me caktimin e kontakteve të miturve me të ëmën, Gjykata duke u gjendur pranë kësaj gjendje faktike ka konsideruar se martesë ka humbur qëllimin dhe efektin e vetë për të cilën është lidh, përkatësisht martesë lidhet në bazë të dashurisë, besnikërisë si dhe vullnetit reciprok të bashkëshortëve. Me qenë se në rastin konkret mungojnë këto elemente qenësore, për ekzistimin e martesës, Gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore të caktuara në dispozitën nenit 69 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Familjen të Kosovës, ku janë paraparë shkaqet e shkurorëzimit, si shkaqe të përgjithshme dhe shkaqe të veçanta. Shkaqet e përgjithshme të shkurorëzimit të parapara në nenin 69 paragrafi 1 të Ligjit për Familjen të Kosovës, bashkëshortët mund të kërkojnë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, si dhe shkaqe që sjellin çrregullim serioz të marrëdhënieve dhe në mënyrë të vazhdueshme. Si shkaqe që sjellin çrregullim serioz të marrëdhënieve serioze mund të jenë: xhelozia, mos përputhja e karaktereve dhe grindja e vazhdueshme e bashkëshortëve, gjersa shkaqet e veçanta janë paraparë në nenin 69 paragrafi 2 të njëjtit Ligj, jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë së bashkëshortëve, vepra penale kundër jetës së bashkëshortëve, keqtrajtimi serioz, lënia qëllim keqe dhe e pa arsyeshme, sëmundjet psikike të pa shërueshme dhe pa aftësia për të vepruar, ndërprerja e pa arsyeshme e jetës faktike bashkëshortore për më shumë se një vit dhe zgjidhja e martesës me marrëveshjen e përbashkët e bashkëshortëve.

Në bazë të nenit 140.1 dhe 2 të Ligjit për familjen të Kosovës është paraparë se kur gjykata me aktgjykim e shkurorëzon ose anulon martesën, me të njëjtin aktgjykim do të vendos edhe për ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur. Pasi që prindërit janë marr vesh për çështjen e mirëmbajtjes së të miturve që të i besohen në ruajtje, mbajtje dhe edukim të atit dhe duke konsideruar se është në interesin më të mirë të tyre të jetojnë me të atin, u vendos të i besohen atij.

Mënyra e mbajtjes së kontakteve personale të miturve me të ëmën propozuesit do ti rregullojnë me marrëveshje.

Propozuesi nuk ka parashtruar kërkesë në emër të ushqimisë për të miturit, bazuar në rrethanat se propozuesja nuk është e punësuar.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr sipas nenit 450 të LPK-së dhe deklarimit të autorizuarve të ndërgjyqësve.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C. nr. 583/17, Datë 18 janar 2018

Kryetarja e kolegjit
Afijete Sada-Gllogjani

UDHËZIM JURIDIK: Ky Aktgjykim është i formës së prerë, sepse të autorizuarit e ndërgjyqësve kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë.